REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË

DAR QARKU

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë në zbatim të ligjit Nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Urdhërit Nr.344, datë 19.08.2013 "Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social", shpall konkurimin për **4 (katër)** vende të lira në pozicionin **Psikolog**, në Njësinë e Shërbimit Psiko-Social të shkollave në varësi të Drejtorinë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë.

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT.

• Psikologu: Të ketë mbaruar arsimin e lartë, në fushën e Psikologjisë (Diplomë universitare "Bacelor" në degën e Psikologjisë, si dhe studime Master Shkencor në Psikologjinë Shkollore ose "Psikologji Klinike" ose Master Profesional "Këshillim psikologjik" ose në drejtime të tjera të përafërta).

• Të ketë njohuri të mira të një gjuhe të huaj, me përparësi gjuhën angleze.

• Të zotërojë njohjen e programeve bazë kompjuterike.

• Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese dhe të punës në grup.

Paraqitja e dokumenteve: Kandidati duhet të paraqesë brenda ***orës 16.30 të datës 02.06.2016,*** në Sekretarinë e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë, me adresë: Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë, këto dokumenta: Kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, të librezës së punës, të çertifikateve të kualifikimit, dëshmive të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti të lëshuar brënda 3 mujave) si dhe të paktën 1 (një) letër rekomandimi, një numër telefoni për tu kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit. (Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit).

Pas verifikimit paraprak, me datë ***06.06.2016***, në ambientet e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë si dhe në dartiraneqark.arsimi.gov.al, do të shpallet lista e konkurentëve, që do të

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu" Tel. 04 379 948
e_mail: darqarkutirane@yahoo.com

vazhdojnë më tej konkurimin si dhe data kur do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë.

Konkurimi do të bazohet në njohuri mbi Ligjin Nr.69/2012 "Për sistemin arsimir parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Urdhërit Nr.344, datë 19.08.2013 "Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social", Manuali i psikologut, Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar, si dhe njohuri specifike për pozicionin e vendit të punës.

D R E J T O R

Eglantina METANI



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu" Tel. 04 379 948
e_mail: darqarkutirane@yahoo.com